

**VENDIM**  
**Nr. 848, datë 26.12.2024**

**PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË  
KOMBINUAR TË MALLRAVE 2025<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12, të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005, "Për nomenklaturën e kombinuar të mallrave dhe tarifën e integruar doganore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2025.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

---

<sup>1</sup> Përafuar pjesërisht me rregulloren zbatuese të Komisionit (EU) 2024/2522, të datës 31.10.2024, e cila ndryshon aneksin I, të rregullores (EEC) nr. 2658/87, "Mbi nomenklaturën tarifore dhe statistikore dhe mbi tarifën e përbashkët doganore".